



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

**PËR ÇELJEN E PROCEDURËS PËR DHËNIEN E 1 LICENCE PRIVATE
LOKALE TRANSMETIMI AUDIOVIZIV NUMERIK, PËR QARKUN ELBASAN
(ALLOTMENTI ELBASAN)**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për dhënien e licencave të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore” miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 100, datë 07.06.2017, si dhe vendimit të AMA-s, nr. 120, datë 30.09.2019 “Për çeljen e procedurës të dhënies së 1 licence private lokale transmetimi audioviziv numerik, për Qarkun Elbasan” në muajin nëntor 2019, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënien e 1 licence private lokale transmetimi audioviziv numerik të përbëra nga:

1. Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
2. Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin dhe vënien në funksionim të 1 rrjeti numerik lokal, në teknologjinë DVB-T2, me standardin e kompresionit MPEG-4.

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pikat transmetuese	Kanali (CH)
1.	Qarku Elbasan	Operator numerik privat lokal	Petresh Çervenakë Librazhd	37

Ftohen subjektet televizivë privatë vendorë analogë të pajisur me licencë për ofrim shërbimi në rrjet analog në zonën Elbasan, për arritjen e marrëveshjes së përbashkët dhe paraqitjen e aplikimit për marrjen e licencës private lokale të transmetimit audioviziv numerik, për qarkun Elbasan.

Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë private lokale të transmetimit audioviziv janë të lutur që të deponojnë aplikimin në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II, 1001, Tiranë, brenda datës 18.11.2019.

Dokumentacioni i plotë i licencimit, që përfshin:

- Rregulloren “Për dhënien e licencave të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”.

- *Karakteristikat teknike të transmetimit dhe karakteristikat teknike të stacioneve transmetuese.*

Mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA

Aplikimet do të hapen më datë 18.11.2019, ora 10.00, në mjediset e AMA-s ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.